



Fletë-informacioni mbi martesën në Zvicër: Të drejtat dhe detyrat

Të dhënat e mëposhtme ju informojnë për të drejtat dhe detyrat në lidhjen martesore në Zvicër. Për këtë arsye janë të vlefshme dhe vlejné vetëm ligjet në fuqi.

Zyrat e gjendjes civile zvicerane dhe përfaqësitë zviceranë jashtë vendit, të cilat ju a japin këtë fletë-informacion, sikurse dhe zyrat e kantoneve përgjegjëse për çështjet civile, nuk e kanë për detyrë këshillimin e detajuar. Për pyetje të mëtejshme në lidhje me këtë fletë-informacion, ju lutem adresohuni tek një këshilltar privat (Zyre këshillimesh, Avokat/e, Noter/e, etj.)

Të drejtat dhe detyrat e lidhjes martesore në Zvicër

Të dhënat e mëposhtme janë të drejtat dhe detyrat më të rëndësishme në një lidhje martesore në Zvicër. Detajet e mëposhtme nuk duhen të jenë sipas rendit.

- **Martesa është e mundur nga mosha 18-vjeçare:** Në Zvicër është e mundur martesa për gra dhe burra nga mosha 18-vjeçare. Pasi të dy partnerët i kanë mbushur tetëmbëdhjetë vjet, është e mundur të lidhet martesa.
- **Secila dhe secili mundet të zgjedhë partnerin lirshëm, asnjëri nuk mund ti detyrojë për të lidhur martesë:** Martesa mund të lidhet me dëshirë të plot nga të dy partnerët. Asnjëri nuk mund të detyrohet kundër dëshirës për të lidhur martesë.
- **Martesa garanton besnikëri dhe përkrahje:** Të martuarit duhet të bashkëpunojnë shoqërisht me dëshirë të plot me njeri-tjetrin për të respektuar personalitetin e njeri-tjetrit. Asnjëri nga të martuarit nuk duhet të bëjë diçka pa dëshirën e tjetrit.
- **Të njëjtat të drejta për gruan dhe burrin në të gjitha çështjet:** secili bashkëshort ka të drejtën e njëjte në vendimmarrje në të gjitha rastet; mendimi i tij/saj kanë vlerën e njëjte.
- **Marrëveshje e përbashkët për ndarjen e punëve në martesë (Punët jashtë shtëpisë, punët e shtëpisë):** pasi që të dy bashkëshortët janë të barabartë, nuk ka ndarje të detyrat sipas gjinisë. Detyrat që lidhen me martesën janë gjithmonë detyra të përbashkëta. Bashkëshortët pajtohen reciprokisht se kush është përgjegjës për cilat detyra.
- **Të ardhurat (financiare) të përbashkëta për mbajtjen e familjes:** edhe këtu, nuk ka ndarje të detyrat sipas gjinisë; bashkëshortët janë të detyruar të kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes. Ata bien dakord se si secili kontribuon.
- **Kujdesi i përbashkët për fëmijët:** Të martuarit e kanë për detyrë kujdesin e fëmijëve, për t'i edukuar, për t'u kujdesur dhe për t'i mbrojtur nga rreziqet.
- **Jo dhunë në martesë:** ai/ajo që godet ose keqtrajton bashkëshortin e tij ose bashkëshorten të saj është i dënueshëm. Çdo lloje dhune fizike ndaje njeri tjetrit e ndaluar.
- **Secila nga palët ka të drejtë, për të kërkuar mbrojtje juridike:** Në qofte se njeri nga të martuarit dëmton të drejtat e tjetrit: Në qofte se nuk përmbushen detyrat martesore kundrejt familjes ose të martuarit nuk janë dakord për çështje të rëndësishme, mund ti kërkojnë ndihmë nga gjykata.
- **Secili bashkëshort ka të drejtë të paraqesë kërkesë për divorc:** martesa mund të zgjidhet me divorc. Nëse të dy bashkëshortët duan divorc, ata mund të paraqesin një kërkesë të përbashkët në gjykatë. Nëse vetëm një nga dy personat dëshiron divorc, ata mund të paraqesin një kërkesë të njëanshme në gjykatë.